REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës * Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 119/26 Dt. 13.03.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, bazuar në ftesën e GIZ-it, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Përparim Shalës-zyrtar publik në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për në Shkup të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnim/punëtorinë me temën: "Modulin II të Akademisë së Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban Rezistues ndaj Klimës" e cila do të mbahet nga data 16 mars 2026 deri me 19 mars 2026, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve dhe shpenzimeve të udhëtimit për të lartcekurin, konform akteve ligjore për udhëtimet zyrtare.

2. Shuma e lejuar, e përshkruar në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

3. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.